



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

**MBI PROCEDURAT DHE KËRKESAT SHITESË PËR LICENCIMIN E
DEPOZITARIT TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 128, datë 06.10. 2011

Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 173, datë 30.11.2017

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e procedurave dhe kërkesave shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Neni 2
Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", (këtu e më poshtë "Ligji"), neni 42 paragrafi 1.

Neni 3
Marrëveshja me depozitarin

1. Marrëveshja ndërmjet depozitarit dhe shoqërisë administruese nënshkruhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Ligj dhe depozitohet në Autoritet jo më vonë se (30) ditë nga data e nënshkrimit të saj, në një kopje origjinale.
2. Depozitari nuk ka të drejtë të kërkojë nga anëtari i fondit të investimit tarifa, komisione, apo pagesa të tjera të ngjashme, përveç atyre të dakordësuara në marrëveshjen ndërmjet depozitarit dhe shoqërisë administruese.

Neni 4
Kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit

1. Përveç sa parashikohet në Ligj, subjekti Bankë që kërkon të licencohet si depozitar i sipërmarrjeve të investimeve kolektive duhet:
 - a) të jetë i licencuar nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e shërbimeve të kujdestarisë, depozitimit dhe të besimit;
 - b) të ketë opinion pozitiv në raportet e auditit financiar për 3 vitet e mëparshme;
 - c) të ketë një njësi organizative të veçantë, e cila është teknikisht e kualifikuar të ushtrojë aktivitetet e depozitarit të parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore;
2. Kërkesat teknike që duhet të përmbushë njësi organizative, me qëllim kryerjen e aktivitetit të depozitarit janë:
 - a) të zotërojë pajisjet e përshtatshme kompjuterike;
 - b) të zotërojë program kompjuterik për kryerjen e aktiviteteve të depozitarit;
 - c) të disponojë linja komunikimi të ngritura, me qëllim marrjen e instruksioneve dhe për komunikim të përgjithshëm me klientët nëpërmjet, SWIFT, faks, telefon dhe internet;
 - d) të ketë miratuar dhe të operojë nëpërmjet procedurave të shkruara për marrjen e instruksioneve nga klientët për menaxhimin e letrave me vlere dhe parasë (cash);
 - e) të ketë miratuar dhe të veprojë në bazë të rregullores së depozitarit për operacionet me shoqëritë e administrimit, të parashikuara në marrëveshjen midis kësaj të fundit dhe Depozitarit;
 - f) të ketë lidhur marrëveshje me një regjistër letrash me vlere nëse është e nevojshme;
 - g) të ketë marrëveshje me një depozitar të huaj nëse është e nevojshme dhe në interes të klientit;
 - h) të ketë lidhje me një depozitar të huaj që ofron informacion financiar në interes të SIK dhe shoqërive administruese në kohe reale, nëse është e nevojshme dhe në interes të klientit.

Neni 5

Dokumentacioni që duhet dorëzuar në Autoritet

Përveç sa parashikohet në Ligj, subjekti Bankë që kërkon të licencohet si depozitar i sipërmarrjeve të investimeve kolektive dorëzon pranë Autoritetit:

- a) dokumentacionin e nevojshëm që tregon se licenca për ushtrimin e aktivitetit bankar i lejon të ushtrojë edhe veprimtarinë e depozitarit;
- b) një deklaratë të Bordit të Drejtorëve të bankës, ku shprehet që banka është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat financiare të legjislacionit bankar dhe legjislacionit në fuqi, në fushën financiare;
- c) një deklaratë nga Bordi i Drejtorëve të bankës, ku shprehet se, banka nuk ka dhe nuk do të zotërojë në të ardhmen aksione në një shoqëri administrimi të fondeve kolektive të investimit, për të cilën ofron shërbimet e depozitarit, apo në njësi që konsiderohet pale e lidhur me atë shoqëri administrimi, apo të mbajë çfarëdo lidhje financiare me këta persona, përgjatë gjithë periudhës që zotëron licencën;
- d) një deklaratë nga Bordi i Drejtorëve të bankës, ku shprehet se banka nuk ka dhënë dhe nuk do të japë apo marrë para (investojë vlere financiare), nga shoqëria e

- administrimit që administron asetet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive për të cilat ushtron shërbimin e depozitarit apo prej ndonjë pale të lidhur, përgjatë gjithë periudhës që zotëron licencën;
- e) një deklaratë nga Bordi i Drejtorëve të bankës, ku shprehet se banka nuk ka dhe nuk do të ketë, përgjatë gjithë kohës se zotërimit të licencës, punonjës ose anëtarë të stafit apo anëtarë të Bordit të Drejtorëve, të cilët janë:
- i. anëtarë të organeve drejtuese apo punonjës të shoqërisë së administrimit që administron sipërmarrjet e investimeve kolektive, për të cilat ushtron shërbimin e depozitarit;
 - ii. anëtarë të organeve drejtuese apo punonjës të çdo pale të lidhur me shoqërinë e administrimit që administron sipërmarrjet e investimeve kolektive për të cilat ushtron shërbimin e depozitarit.
- f) dokumentacionin mbi strukturën organizative të bankës, ku të tregohet krijimi i njësisë organizative me funksion veprimtarinë e depozitarit;
- g) opinionin e ekspertit kontabël për raportet financiare;
- h) dokumentacioni që vërteton plotësimin e kërkesave të nenit 4, paragrafi 2 i kësaj rregulloreje.

Neni 6

Dhënia e licencës

1. Autoriteti merr vendim për dhënien e licencës së depozitarit brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të dokumentit të fundit nga ana e aplikuesit.
2. Autoriteti miraton licencën nëse bindet që aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit dhe kësaj Rregulloreje dhe ka kapacitetet teknike për ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit.

Neni 7

Depozitari i fondeve të pensionit

1. Në rastet kur Banka ose dega e bankës se huaj zotëron licencën e ushtrimit të veprimtarisë së depozitarit për fondet e pensionit, lëshuar në përputhje me Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Mbi fondet vullnetare të pensionit” dhe kërkon të zgjerojë licencën për të ushtruar veprimtarinë e depozitarit për sipërmarrjet e investimeve kolektive, duhet të:
 - a) dorëzojë një kërkesë zyrtare për zgjerimin e licencës pranë Autoritetit, duke argumentuar kapacitetet për ushtrimin e aktivitetit të kërkuar;
 - b) Autoriteti nëse e sheh të arsyeshme, ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe kësaj Rregulloreje;
2. Autoriteti, brenda 60 ditëve nga marrja e dokumentit të fundit të kërkuar nga aplikuesi merr vendim për dhënien ose jo të miratimit të zgjerimit të licencës së Depozitarit të fondeve të pensionit edhe për të ushtruar veprimtarinë e depozitarit për sipërmarrjet e investimeve kolektive.

Neni 8
Nëndepozitari i huaj

Depozitari mund të kontraktojë një nëndepozitar të huaj, nëse është e nevojshme për investimet jashtë territorit të Shqipërisë, sipas marrëveshjes me shoqërinë administruese.

Para nënshkrimit të kontratës me nëndepozitarin e huaj, depozitari merr miratimin me shkrim nga Autoriteti, pas plotësimit të kërkesave të përcaktuara në një udhëzim të veçantë.

Kontrata me nëndepozitarin e huaj nuk kufizon përgjegjësinë ligjore të depozitarit.

Neni 9
Tarifat ndaj Autoritetit
(shfuqizuar)

Neni 10
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI